

NEW ENTRIES IN THE FIELD OF LANGUAGE SHPREHJET E REJA GJUHËSORE

Albulena ZULBEARI¹

¹ Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: albulena.zulbeari@unite.edu.mk

Abstract

The purpose of this paper is to take a closer look at how young people always tend to introduce new words and terms into a language. This is due to the overuse of social networks, promotions in media, and more. The immediate development of technology. The changing way of communication between them has led to many foreign expressions and words being introduced into the language. In this paper we have tried to look at how young people communicate with one another, do they use the standard language among themselves, do they speak the same in front of professors, and do they then differ in communication between their social circle. We will also note that there are also students who try to speak the standard, to criticize others for improving their correct use of language. The entry of new words and constructions in a language is first and foremost a response to the economic and social development of a country.

Thus, the Albanian language is obliged to create, but also to borrow a large number of words from the languages with which it has the most intense relations. The main methods will be empirical, comparative as well as visual where we will dedicate ourselves to the paper. In the Albanian language, we have many words that came from the influence of the Ottoman Empire, as well as words from the Slavic languages, by which I mean that Albanian already has a certain amount of foreign words, which is now joined by English and other languages that are most influential in the world which make Albanian a language with many new expressions. In the end, we should see how valuable those words are in the vocabulary of the Albanian language.

Keywords: *words, expressions, foreign, borrow, use.*

Përmbledhje

Qëllimi i këtij punimi është për të parë më nga afër se si të rinjtë përherë kanë tendencë për të futur fjalë e shprehje të reja në gjuhë. Kjo vjen si pasojë e përdorimit të tepërt të rrjeteve sociale, zhvillimit të mediave etj. Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë. Ndryshimi i formave të komunikimit mes tyre ka bërë që në gjuhë të futen shumë shprehje e fjalë të huaja. Në këtë punim ne jemi munduar të shikojmë se si të rinjtë komunikojnë njëri me tjetrin, a e përdorin gjuhën standarde mes vete, a flasin njëjtë para profesorëve dhe a ndryshojnë mandej në komunikimin e lirë në rrethin shoqëror. Gjithashtu këtu do të vërejmë se kemi edhe studentë të cilët mundohen të flasin në standard, t'i kritikojnë të tjerët që të përmirësohen në përdorimin e drejtë të gjuhës. Hyrja në gjuhë e fjalëve dhe ndërtimeve të reja, është si nevojë për t'iu përgjigjur zhvillimit ekonomik, zhvillimit social e shoqëror të një vendi.

Pra, gjuha shqipe detyrohet të krijojë mjaft fjalë të reja, po edhe të marrë hua shumë fjalë nga gjuhët me të cilat ka kontakte më të shpeshta. Metodat kryesore do t'i kemi empiriken, krahasuesen si dhe metodën vizuale. Në gjuhën shqipe, kemi një numër të madh të fjalëve të cilat kanë hyrë nga ndikimi i Perandorisë Osmane, po ashtu kemi edhe fjalë nga gjuhët sllave, me këtë dua të them se shqipja tashmë ka një denduri të fjalëve të huaja që tash i shtohet nga gjuha angleze dhe gjuhët e tjera të cilat janë më me ndikim në botë dhe e bëjnë shqipen një gjuhë me shumë shprehje të reja. Në fund duhet të shohim se sa janë të vlefshme ato fjalë në fjalorin e gjuhës shqipe.

Fjalët kyçe: *fjalë, shprehje, e huaj, huazim, përdorim.*

1. Hyrje

Qëllimi i këtij punimi është për të parë se si të rinjtë përherë kanë tendenca që të përfshijnë fjalë e shprehje të reja në gjuhë. Rezultati i kësaj vjen ngaqë ata i përdorin rrjetet sociale më shumë, janë në hap me ndryshimet e reja të mediave etj. Ky zhvillim i hovshëm i teknologjisë, format e ndryshme të komunikimit mes njerëzve kanë bërë që në gjuhë të futen shumë fjalë të reja.

Në këtë punim, jemi munduar të shikojmë brenda Universitetit të Tetovës se si studentët komunikojnë njëri me tjetrin, a e përdorin gjuhën standarde mes vete, a flasin njëjtë para profesorëve dhe a mundohen të ndryshojnë kur komunikojnë me rrethin shoqëror. Gjithashtu këtu do të shohim, se kemi edhe studentë të cilët mundohen të flasin në standard, t'i kritikojnë të tjerët për t'u përmirësuar në përdorimin e drejtë të gjuhës.

Fjalët e reja që hyjnë në një gjuhë, para së gjithash u përgjigjen nevojave të zhvillimit ekonomik. Gjuha shqipe, duke qenë gjuhë aktive dhe me një përdorim të gjerë, ajo detyrohet të marrë fjalë nga gjuhë të tjera e njëkohësisht edhe të krijojë fjalë të reja, gjithnjë duke iu përgjigjur zhvillimit të hovshëm ekonomik, social, akademik, shoqëror etj. Fjalët të cilat i marrim hua nga gjuhët e huaja dhe ato të cilat i krijojmë, të gjitha duhet të kenë një filtrim dhe të njëjtat të analizohen nga njerëz të fushës, kryesisht nga gjuhëtarët. Pra, kjo prurje që vjen sidomos nga gjuha angleze, por edhe nga gjuhët e tjera, nuk mund t'i nënshtrohet direkt fjalorit të gjuhës shqipe. Në vijim do të shohim se si të rinjtë flasin mes vete dhe çfarë shprehjesh gjuhësore kanë bërë pjesë të gjuhës së tyre.

2. Shprehjet e reja gjuhësore

Kohët e fundit, në sistemin gjuhësor të shqipes janë futur me qindra shprehje të reja leksikore. Për këtë kanë kontribuar rrugët e zakonshme të pasurimit të fjalorit të një gjuhe, që janë formimi i fjalëve të reja me brumin e gjuhës, nëpërmjet prejardhjes dhe përbërjes, dhe sidomos huazimit leksikor (Omari, 2011:175).

Kristal (Crystal, 1992) i cilëson termat e huazuar si prurje fonologjike, morfologjike, leksikore dhe sintaksore nga një gjuhë ose varietet në një gjuhë tjetër. Kurse, Rodriges (Rodrigues, 1996) e konsideron termin "huazim" si të papërshtatshëm dhe të paplotë semantikisht në përshkrimin për marrëdhëniet gjuhësore. Nga kjo, kuptojmë se studentët në ligjërimin e lirë, por edhe në komunikimin përmes rrjeteve sociale përdorin më shumë huazimet nga gjuha angleze. Të shumtë janë shembujt si: *nice* për shkëlqyeshëm, *weekend* për fundjavë, *trendy* për ...e kohës, *sms* për mesazh, *like* për më pëlqen etj.

Shohim se fjalët e huaja e kanë fjalën gjegjëse në gjuhën shqipe, kjo nuk tregon apo nuk paraqet ndonjë vështirësi për kuptim. Mes tyre kemi edhe fjalë të cilat cilësohen si ndërkombëtare, të cilat vijnë nga fusha e sportit, mediave, ekonomisë, elektronikës, etj., për shembull: *background*, *birthday*, *viber*, *facebook*, *whatsapp*, *sms*, *trendy*, *look*, *show*, *CV*, *draft* etj.

Nga analiza që bëmë, vërejtëm se huazimet mund të jenë të drejtpërdrejta, (I) me këtë kuptojmë se huazimi shpreh kuptimin e njëjtë në të dyja gjuhët, si: *weekend* (fundjavë), *trendy* (e kohës), *nice* (shkëlqyeshëm), *shopping* (pazar), etj; (II) kur shënohen njëjtë si në gjuhën e huaj, gjithashtu edhe nyjëtimi është i njëjtë, p.sh.: *hobby*, *facebook*, *whatsapp*, etj; (III) këtu bëjnë pjesë ato huazime kur fjala në gjuhën shqipe mungon, por shqiptimin e kemi të njëjtë, si: *chips*, *hamburger*, *fast food*, *pizza*, *sandwich*, *hot dog*, etj. Me këtë, fjalori i gjuhës pëson një zgjerim brenda vetës, zgjerim të kuptimeve, të fjalëve etj.

Punimi bën tentativë për të treguar një vlerësim stilistik e tërësor të gjuhës së studentëve, ku përmes analizës së leksikut të tyre të analizohen gjitha njësitë e fjalëve që përdorin ata në ligjërim. Gjatë bisedës së lirë mes studentëve, vërejtëm se, ata përdorin mjaft huazime të cilat nuk janë të nevojshme, por i përdorin kinse me qëllim stilistikor, si: *OK, beauty, cool, out, funny, t'kissi, bye-bye, lovi, çao (ciao), on air, whats up, it's ok*.

Më hollësisht ata analizohen më poshtë.

E kemi shprehjen “E downloadova materialin”- kjo folje download-ova, është një folje në gjuhën angleze, e cila në gjuhën shqipe ka këtë kuptim: download (alb. < shkarkoj). Në këtë rast duke i shtuar mbaresën e kohës së kryer të thjeshtë (aoristi) -ova , pra download + ova është formuar folja shkarkova. Kjo nuk mund të konsiderohet si një shprehje grupi, por si shprehje personale, e cila përdoret nga ata studentë që duan të tregojnë se janë njohës të mirë të gjuhës angleze.

Shprehja “Bëje delete” - kjo folje që vjen nga gjuha angleze në gjuhën shqipe ka kuptimin “fshije”, këtë shprehje shumë shpesh e dëgjojmë nga studentët e gjuhës angleze, po edhe të tjerë. Këto shprehje përdoren si një modë mes të rinjve, por edhe te më të vjetrit e dëgjojmë, pasi siç kemi përmendur këto janë rezultat i teknologjisë që përdoret sot me të madhe ndër njerëz. Ky komunikim në përditshmëri mes studentëve, mund të çojë në mospërdorimin e fjalëve të gjuhës shqipe e si pasojë mund të shkojë deri edhe në shkrirjen e disa prej tyre.

Përveç shembujve që tregova më lart, e kemi fjalën *OK* e cila gjen një përdorim shumë të dendur jo vetëm te studentët, por atë e dëgjojmë edhe nga fëmijët, nga profesorët, lirisht mund të themi se më shumë dëgjojmë fjalën *OK* se sa *mirë* që është gjegjëse në gjuhën shqipe.

Përdorimi i huazimeve të tilla, nuk duhet shikuar si negativ deri sa këto huazime apo transformime gjuhësore përdoren vetëm në mënyrë individuale, pra pa mos kaluar në sistemin e fjalorit apo në atë morfologjik të gjuhës shqipe. Shqipja, është një gjuhë e cila është në proces të vazhdueshëm për pasurimin e fjalorit, e shprehjeve të reja nga gjuhë të tjera madje edhe nga vetë të folmet e dialekteve të saj, por gjithmonë duke u shikuar nga gjuhëtarët e duke pasur një vëzhgim profesional në futjen e tyre në gjuhë.

3. Përfundimi

Rezultatet e këtij hulumtimi na tregojnë se të rinjtë i përdorin vend e pa vend fjalët e huaja si dhe ato krahinore. Duke përdorur huazime e shprehje të tilla, ata nuk janë të vetëdijsëm se i bëjnë një shkelje të madhe normës letrare të gjuhës shqipe e cila është vendosur në vitin 1972. Këtë fenomen nuk e hasim vetëm ndër studentë, por edhe nga profesorë, mjekë e shumë të tjerë të fushave të ndryshme jetësore.

Në ligjërimin e folur, jashtë universitetit, është hasur prania a varianteve dialektore, e cila ndikohet nga faktorët gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë, si e folmja e Tetovës, fshatrave përreth, e folmja e Gostivarit, e folmja e studentëve që vijnë nga Kosova apo Lugina e Preshevës etj. Përdorimi i gabueshëm i gjuhës standarde vërehet në shqiptimin e tingujve, rrokjeve, e fjalëve në shpërpjesëtim me kriteret drejtshqiptimore të njësive gjuhësore (Mujaj, H. 2011:366).

Shkelje të fjalëve të gjuhës shqipe vërehen jo vetëm në sistemin morfologjik, por edhe në aspektin fonetik, si: ndryshime të intonacionit, ngjyresa të të folmeve nga vendet që vijnë, kemi humbje të zanoreve, dallime jo të mjaftueshme mes zanoreve dhe bashkëtingëlloreve, përdorime të gabuara të theksit, zgjatje dhe shkurtim të zanoreve varësisht nga vendet që vijnë, gabime në shqiptimin e fonemave etj.

Folësit dhe folëset i shqiptojnë fjalët përgjithësisht sipas të folmes lokale. Pra, mbizotëron shqiptimi i disa fjalëve me *i*, si: *gjikata*, *si*, *ilberi* etj., të cilat duhet të shkruhen dhe shqiptohen me *y*, si: *gijkata*, *sy*, *ylberi*. Ndërkaq aty ku nuk duhet të jetë zanorja *y* nga folësit vendoset, p.sh.: në masë të madhe e dëgjoj *kypa* në vend *kripa*.

I. Gabime në gjuhën shqipe dëgjojmë edhe në shqiptimin e zanores -ë paratheksore: fjalët e tilla si; *mirëkuptimi*, *gojëtar*, *punëtor* etj., disa studentë i shqiptojnë si duhet këto fjalë e sidomos këtë zanore, por disa të tjerë fare nuk e shqiptojnë: *mirkuptim*, *gojtar*, *puntor* etj.

II. Në të folurën tonë, gabime vërehen edhe në shqiptimin e bashkëtingëllores -rr (Lafe, 2004:14): fjalët që shkruhen me *rr* në bazë të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, në këtë të folur shqiptohen me -r, të rrallë janë të rinjtë që i përdorin si duhet p.sh.: *karige*, *resht*, *karocë* që duhet të jenë *karrige*, *rresht*, *karrocë*.

III. Gabim i ngjashëm vërehet edhe në shqiptimin e bashkëtingëllores /h/. Shumica e të rinjve përdorin variante pa /h/ për mbiemrat; *i/e mpretë*, *i/e zbetë*, *i/e nxetë*, që duhet të jenë *i/e mprehtë*, *i/e zbehtë*, *i/e nxehtë* etj.

Shumica e studentëve flasin ashtu siç flasin në shtëpi dhe janë të paktë ata të cilët duan ta ndryshojnë gjuhën në tendencat e gjuhës standarde. Kemi raste, kur dëgjojmë se disa studentë mundohen t'i korrigjojnë të tjerët në përdorimin e drejtë të gjuhës, sidomos kur ata shpjegojnë diçka para profesorit ose para studentëve të tjerë, por këta studentë janë të paktë dhe ndaj atyre shpesh lëshohen tallje nga shokët, pasi kinse duan të duken më të ditur.

Sipas profesor Shkurtajt (2003:77), dyndja e pashfrenueshme e fjalëve të huaja të panevojshme në gjuhën shqipe, sidomos nga anglishtja dhe italishtja, shtimi i termave të huaj në vend të termave shqip që përdoren normalisht dhe nuk ka pse të mënjanohej është “dallga” më e re e huazimeve në një gjuhë që tashmë ka mjaft turqizma në leksikun e saj. Huazimet e tilla, të cilat përdoren nga gjeneratat e reja, kanë ndikuar që në leksikun e gjuhës të futen shprehje të cilat përkojnë me aspekte të ndryshme jetësore sidomos shprehje që kanë të bëjnë me teknologjinë. Por, kjo nuk është vetëm rezultat i gjuhës, po edhe i zhvillimit të hovshëm në fushën e teknologjisë, e cila, e ka bërë të patjetërsueshme përdorimin e disa fjalëve a shprehjeve të caktuara.

Studiuesi, Ardian Vehbiu shprehet se: “Na mungon teknologjia gjuhësore për të përballuar anglishten teknologjike. Teksa dëgjon të rinjtë kur thonë bëje *save*, bëje *reboot*, bëje *download*, bëje *setup*, bëje *delete*, gjuhëtarit i kujtohen togje të tipit bëj *derman*, *bëhu mukajet*; në këto raste, sistemi reagon ndaj kësaj ofansive trullosëse, pasi që anglicizmat, si orientalizmat dikur, nuk integrohen dot vetvetiu dhe natyrshëm në sistemin morfologjik të shqipes” (Vehbiu, 2011:444).

Ndikimi i rrjeteve sociale, ndikimi i mediave, zhvillimi i teknologjisë, lëvizja në vende të ndryshme të Evropës si dhe dëshira e madhe për t'u dukur më ndryshe dhe më modernë ka bërë që të vijnë këto huazime gjuhësore. Duke parafrazuar studiuesin Xhevat Lloshi, ku ai shprehet se, 30% ndoshta përqindje më e madhe e popullit njohin, si gjuhën angleze, gjermane, italiane, maqedonase apo ndonjë gjuhë tjetër, si gjuhë të dytë. Huazimi i fjalëve të tilla, sidomos i anglicizmave vjen në shqipe si një kuadrin e një dygjuhësie të çalë, d.m.th., nëpërmjet shqiptarëve që nuk e dinë mirë anglishten dhe nuk kanë as ndershmërinë dhe as përgjegjësinë më të vogël që para se të përdorin fjalët në anglisht, t'i shohin se si përkthehen në fjalorët anglisht-shqip (Shkurtajt, 2003:79).

Problemet e tilla që dalin nga ligjërimi studentor, i shohim në këto pika:

- Prania e madhe e fjalëve të huaja si dhe përdorimi i tyre me një denduri të madhe, si këto: *kolokium*, *konsultim*, *bye*, *ciao*, *love you*, *okay*, *it's okey* etj.

- Përdorim i sinonimeve për të njëjtën fjalë. Këto sinonime i hasim më shumë në lëmin e ekonomisë, biznesit, juridik etj., ku shprehjet përdoren edhe në shqip edhe në gjuhë të huaj, si: *copy* dhe *kopjoje*, *konvertim* dhe *kthim*, *draft* dhe *projekt* etj. Futja e fjalëve të huaja veçanërisht nga anglishtja është bërë një fenomen shumë i përhapur, gjë që e vërejmë edhe nga shtresat e larta të shoqërisë, të cilët ngjashëm si studentët me idenë se përmes saj do të mund të shprehen më mirë, apo ta japin mesazhin më drejtë, shpesh edhe për t'u dukur se lexojnë diçka më shumë përdorin fjalë të tilla, për këtë, Jani Thomai me shumë të drejtë këtë dukuri e ka quajtur “snobizëm gjuhësor” (2000:53).

- Shkelje më e madhe është, kur fjalët shqiptohen me theksin e gjuhës së huaj, si; *kompjuter*, *iphon*, *wi-fi* etj.

- Studentët shumicën e rasteve përdorin fjalë të huaja për t'u dukur ma modern apo siç ata e quajnë më “in”, me të cilat shpesh arrijnë edhe në banalitet. Kur duan të dallohen dhe mos kuptohen nga shoqëria ata përdorin zhargone të ndryshe, këto zhargone shpesh janë edhe me nuanca humori. Zhargonet që përdorin paraqesin një të folme të veçantë, shpesh me fjalë e shprehje të huaja, me nuanca dialektore, gjuhë e fëmijëve e shpesh herë edhe të folme rrugësh, ku me shumë keqardhje mund të themi se këto të folme kanë marrë përmasa shumë të gjera në gjithë shoqërinë tonë.

Synimi i gjethe kësaj të folme në ligjërimin bisedor është për t'u treguar të ditur, për t'u treguar të tjerëve se ndjekim dokumentare të ndryshme apo shohim emisione të ndryshme, për të treguar se sa lexojmë etj. ku ideja kryesor është të tregohemi më lartë se tjetri, por në këtë pikë harrojmë një gjë kryesore, asnjëherë nuk mund të arrijmë diku nëse e shmangim apo nuk e flasim gjuhën tonë.

Mendoj se gjuhëtarët duhet të merren seriozisht me këtë të folme e cila ka marrë përmasa të gjera ndër të rinjtë. Të shikohen fjalët, të ketë sistem filtrimi dhe të mos lejohet që shprehjet të cilat më veçse janë të pranishme në gjuhë, të zëvendësohen nga fjalë e shprehje të huaja.

Referencat

- [1]. Drew, P., & Holt, E., 1998, Figurative expressions and the management of topic, Translation in conversation, Cambridge.
- [2]. Floqi, S., 1969, Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme, Tiranë, *Konferenca e dyte e studimeve Albanologjike*.
- [3]. Hysa, R., 1998, Fjalor anglisht-shqip, Tiranë.
- [4]. Lafe, E., 2000, Gjuha e medias sot—probleme dhe detyra, Tiranë.
- [5]. Lloshi, Xh., 1972, Shënime për fjalën dhe togfjalëshin, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, f.439.
- [6]. Marashi, A., Shqipja në etapën e sotme: sfidat e gjuhës dhe të gjuhëtarëve, Tiranë.
- [7]. Mujaj, H., 2011, Zbatimi i gjuhës standard në institucionet shtetërore, Tiranë.
- [8]. Omari, A., 2011, Vështrim mbi disa prurje të gjuhës së sotme letrare, Tiranë.
- [9]. Kostallari, A., 1972, Parimet themelore për hartimin e fjalorit të gjuhës së sotme shqipe, Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, II, f.32.
- [10]. Moon, R., 1998, Fixed Expressions and Idioms in English, Clarendon Press f.4.
- [11]. Shkurtaj, Gj., 2003, Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe, Tiranë.
- [12]. Thomai, J., 1999, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë.
- [13]. Thomai, J., 2000, Lëvizje në leksikun e gjuhës shqipe në kushtet e reja historiko-sociale, Shkup, nr. 6, , f. 53.
- [14]. Vehbiu, A., 2011, Leksiku i shqipes së sotme - Sfida të pasurimit, Tiranë.